



Punë e sigurt dhe e shëndetshme në epokën dixhitale



Fushata “Vende pune të shëndetshme” 2023-2025

Ndërsa dixhitalizimi i shpejtë i vendeve të punës ka krijuar shumë mundësi të reja për efektshmëri dhe produktivitet, por sjellë edhe sfida të reja për sigurinë dhe shëndetin në punë (SShP). Këto rreziqe

duhet të vlerësohen dhe menaxhohen në mënyrë të përshtatshme për të siguruar që të gjithë punonjësit në Evropë të mund të kryejnë veprimtaritë e tyre në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme. Fushata “Vende pune të shëndetshme” 2023-25 me temën “Punë e sigurt dhe e shëndetshme në epokën dixhitale”, e organizuar nga Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), synon të rrisë ndërgjegjësimin për ndikimin e teknologjive dixhitale te puna dhe vendi i punës dhe për mënyrën si mund të trajtohet ky ndikim.

Trajtimi i sfidave dhe i mundësive të dixhitalizimit

Dixhitalizimi ka potencial të madh për të përmirësuar sigurinë dhe shëndetin e punonjësve. Teknologjitë dixhitale ndihmojnë në automatizimin e detyrave të përsëritura, duke ulur kështu mundimin fizik dhe përmirësuar ergonominë. Robotët dhe inteligjenca artificiale (IA) mund të mbështesin punonjësit në mjedise pune të rrezikshme. Puna në distancë favorizon elasticitetin dhe një baraspeshë më të mirë ndërmjet punës dhe jetës. Megjithatë, nëse përdoren për periudha të gjata kohe, këto teknologji mund të shkaktojnë edhe mundim fizik, çrregullime muskulore - skeletore si dhe situata me stres të lartë, izolim social ose shëndet të dobët psikosocial.

Përfitimet nga dixhitalizimi mund të gëzohen vetëm nëse rreziqet menaxhohen në mënyrën e duhur. Fushata synon të rrisë njohuritë për rëndësinë e SSHP-së në epokën dixhitale dhe të sigurojë se në vendin e punës zbatohet qasja kundrejt dixhitalizimit me në qendër njeriun.

Teknologjitë dixhitale në vendin e punës janë të sigurta dhe të dobishme për punonjësit, për sa kohë rreziqet potenciale vlerësohen dhe menaxhohen në mënyrën e duhur

Fushat parësore

Fushata strukturohet rreth pesë fushave parësore të identifikuara nga kërkimet e EU-OSHA-së, ku përfshihen pamja e përgjithshme e SSHP-së 2020-23 për dixhitalizimin dhe studimet e saj parashikuese. Këto dokumente hulumtojnë mundësitë që burojnë nga teknologjitë dixhitale, duke trajtuar ndërkohë të gjitha sfidat potenciale:

- punën në platformat dixhitale,
- automatizimin e detyrave,
- punën në distancë dhe atë hibride,
- menaxhimin e punonjësve nëpërmjet IA-së dhe
- sistemet dixhitale inteligjente.

Duke u përqendruar te këto fusha parësore, duke nxitur praktikatat e mira dhe duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e kësaj teme, të gjithë punonjësve në Bashkimin Evropian mund t'u ofrohet një mjedis pune dixhital më i sigurt, më i shëndetshëm dhe më i qëndrueshëm.



Përfshihuni! Merrni pjesë në Çmimet “Praktikat e mira për vende pune të shëndetshme” ose në Javët evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në vendin tuaj.